bëjnë. Drita e jote vetëm me anën e Dijetarvet.

29) D.Xh.D. = O bilbil! Mejtim i yt: me fjalën e tjetrit do që të hyjë në fund të detit, punë që e ke jashtë fuqisë mos e puno se në këtë çast nuk pranohet dhe pranë parsivet mos shko se dëmtohesh; vehten t'a ruejësh se nga miqtë t'uej ke shum armiq, pra: mos ri në gjumë dhe me ta mos u bashko po u bazo vetëm ke i Madhi Zot tue bërë tobe, Istigfar që të të shpëtojë nga të gjith belatë (inshaell-llah).

30) B.D.A. = O çilsi i fatit! Lere kët mejtim që mos pendohesh; bëj durim edhe nja dy javë edhe kërko ndihmë vetëm nga i Madhi ZOT, se në bazë të teveqyl-it gjith punrat t'ueja do të këthehen për hajir (inshaell-llah).

31) B.D.Xh. = O bilbil i fatit! Nga të gjith hidhrimet shpëtove dhe çdo punë t'u këthye hajir e u gëzove. Nga marrëdhënja do të shohish shum hajir se dëshira do të mbarohet (inshaell-llahu teala).

32) B.Xh.A. = O çilsi i fatit! Ka shum njerës që ty të ngrehin hile fshehtas, u ndruaj dhe ke pari e Shtetit ty po të tokon një punë që ngjet si kur ke rënë në Detë. Pra: bëj durim që puna le të këthehet për hajir dhe të arijsh dëshirën (inshaell-llahurrahman).

33) Xh.Xh.Xh. = O bilbil i fatit! Ky fat ngjet

si fat i Hazreti Pejgamberit (A. S.) si kundër ju edhe armiqvet galib, ashtu edhe ti armiqvet t'uej do ju vijsh (forcë) galip me ndihmën e fsheht të Hazreti Pejgamberit. Ti me gjith robët do të miqsosh edhe do të forcohesh. Prej natës si kur ke dalë në dit, ashtu do të késh dritë në të katër anët, do të kesh edhe evlád të mbarë. Ke kalue kohën hidhrim po prap qafon gëzimin me faqe të bardhë. Do të gëzohesh edhe me një pasuni që do të vijë nga s'pandehet. Ke edhe një udhëtim hajir me plot të mira si udhtim i H. Pejgamberit prej Meqqes në Medine (inshaell-llahurrahman).

34) Xh.Xh.A. = O çilsi i fatit! Bëj pak durim se përndryshe të vjen hidhrim. Këtë haxhet mos e kërko, e cila s' pranohet edhe mbreti zemrohet, po me esmai Hysna, me duâ e me sadaka vazhdo që të shpëtosh nga gjith belát e të shtohen hajiret kat e kat (inshaell-llahu teala).

35) Xh.Xh.B. = O çilsi i fatit! Ti ke rënë në hidhrim po prap ke shpëtim. Këti qëllimi bëji durim se për ndryshe ke pendim, hiq dorë nga ky qëllim që të shpëtojsh nga gjith hidhrimet edhe që të kthehet puna për hajir (inshaell-llahu teala).

36) Xh.Xh.D. = O çilsi i fatit! Puno një punë hajir që të fitojsh dëshirën edhe mjafto me atë që të ka falë i Madhi ZOT. Mos ri në gjumë se armiq ke shumë po fati ësht me ty (inshaell-llahu teala).

37) Xh.A.A. = O bilbil i fatit! Ti ke nja dy tre